Public Disclosure Authorized

Public Disclosure Authorized

UKaid from the British people

Kingdom of the Netherlands

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

SWEDEN

WORLD BANK GROUP

YUCOM
Komitet pravnika
za ljudska prava

Botues
Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut – YUCOM
Kneza Miloša 4, 11103 Beograd
www.yucom.org.rs

Për botuesin
Milan Antonijević

Përgatitën
dr Katarina Golubović
Ana Janković Jovanović
Milena Vasić
Danilo Ćurčić
Natalija Šolić

Dizajni dhe faqosja
Dosije studio

Udhëzuesin "Për herë të parë në gjykatë dhe për herë të parë në gjykim" e përgatiti ekipi i Komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut – YUCOM. Ekipi përdori udhëzimet e mara nga znj. George Harley (eksperte për reformën e gjyqësorit), nga z. Sërgjan Svirçev (specialist për sektorin publik), znj. Marina Matiq Boshkoviq (këshilltare për reformën e gjyqësorit), si dhe komentet e dërguara nga Victoria Eskivel Korzak (eksperte për të drejtat e njeriut).

"Ky version është një Draft udhëzues që është ende në ndërtim e sipër. Të gjitha sugjerimet dhe komentet janë të mirëseardhura me qëllim që versioni përfundimtar i këtij udhëzuesi të jetë aq i përshtatur për përdoruesit dhe për të arritur qëllimin e tij të plotë. Të gjitha sugjerimet mund t'i dërgoni me postën elektronike në adresën office@yucom.org.rs. "

UDHËZUES

PËR HERË TË PARË NË GJYKATË

DHE PËR HERË TË PARË NË GJYKIM

PËRMBAJTJA

VETËPËRFAQËSIM. 7

PADITËSI

1. DUA TË PADIS – ÇFARË DUHET TË DI MË PARË 9
2. SHKRUAJTJA E PADISË 10
   2.1 Ligjet dhe të dhënat e nevojshme për shkruajtjen e padisë 10
   2.2 Çfarë të kërkoj nga gjykata – kërkesë padia 13
   2.3 Atëherë kur nuk e di saktë se çfarë kërkoj nga gjykata – saktëzimi i kërkesë padisë 14
3. PARAQITJA E PADISË 14

I PADITURI

1. JAM PADITUR – ÇFARË DUHET TË DI MË PARË 17
2. SHKRUAJTJA E PËRGJIGJES NDAJ PADISË 19
   2.1 Ligjet dhe të dhënat e nevojshme për shkruajtjen e padisë 19
   2.2 Çfarë të kërkoj nga gjykata – refuzimi dhe mospranimi i kërkesë padisë . 19
3. PARAQITJA E PËRGJIGJES NDAJ PADISË 21

6 UDHËZUES

PËR HERË TË PARË NË GJYKATË DHE PËR HERË TË PARË NË GJYKIM

NË GJYKATË

1. Si të përgatitem për t'iu drejtuar gjykatës, çfarë duhet të sjell në gjykatë, si duhet të vishem, si të gjej sallën e gjyqit, çfarë ndodh nëse nuk do të paraqitem? 21
2. Si bëhet gjykimi 23
3. Në sallën e gjyqit … 25
4. Çfarë do të ndodh në seancën e ardhshme? 29
5. Fundi i gjykimit 29

REZULTATET E MUNDURA TË NJË GJYKIMI 30

KUSH MUND T'JU NDIHMOJË?. 32

PËR VETËPËRFAQËSIMIN

Nuk është e lehtë të përfaqësosh të drejtat dhe interesat e tua në gjykatë. Ju do të jeni në terren të panjohur, ku aktorët e tjerë do të flasin një gjuhë të panjohur për Ju, dhe ku nuk do të jeni në dijeni të rregullave që zbatohen. Këto rregulla ndonjëherë janë me shkrim, dhe nganjëherë jo. Ato mësohen përmes viteve të studimit dhe përvojës. E megjithatë, asnjë proces, asnjë procedim, nuk është i njëjtë. Kjo është arsyeja pse askush nuk mund të garantojë rezultatin e një rasti.

KY UDHËZUES NUK PROMOVON VETËPËRFAQËSIMIN. Qëllimi i tij është që T'U AFROHET NJERËZVE SA MË SHUMË PROCESI GJYQËSOR. Ai jep përgjigje për pyetjet që mund të pyesni veten para se të shkoni në gjykatë që nuk mund të gjenden në ligje.

Përfundimisht, shpresojmë që leximi i këtij Udhëzuesi do t'ju lejojë të shihni procesin gjyqësor në mënyrë më realiste dhe kështu të vendosni nëse duhet të gjykoni fare ose të gjeni argumente të mjaftueshme të shëndosha për Ju dhe palën kundërshtare për të zgjidhur në mënyrë miqësore mosmarrëveshjen Tuaj.

EKIPI I YUCOM-IT

PADITËSI

1. DUA TË PADIT – ÇFARË DUHET TË DI MË PARË?

Nëse dëshironi që gjykata të marrë një aktvendim me të cilin një person tjetër (qoftë shtet, firmë apo njeri) do të detyrohet të bëjë diçka ose të mos ta bëjë atë, **duhet të ngrëni një padi kundër atij personi.**

PËR PADINË PAGUHET TAKSA, MENJËHERË NË FILLIM.

Nëse nuk keni mjete për pagimin e taksës, **mund t'i bëni kërkesë gjykatësit që t'Ju lirojë nga pagesa**, sepse sipas gjendjes Tuaj ekonomike nuk keni mundësi të paguani. **Kujdes!!!** Për gjithçka që thoni duhet të keni prova. Do duhet të dorëzoni dokumentacionin (p.sh. vërtetimin për papunësi nga Enti Kombëtar i punësimit, çekun e pensionit, çertifikatat e lindjes për fëmijët, vërtetimet nga komuna për pronën e palëvizhme, etj.) Mund të kërkoni të paguani taksën me këste. Përdorni të drejtat Tuaja brenda afatit.

TAKSA PËR PADI PËR DIVORCIM: RSD 2,660,00

TAKSA PËR PADINË E KTHIMIT TË BORXHIT RSD 900.000,00: RSD 38.300,00

BARRA E PROVËS ËSHTË MBI JU!

Për gjithçka që thoni duhet të keni prova. **SI RREGULL, NËSE NUK KENI PROVA, DO TË HUMBISNI KONTESTIN.**

PROVAT JANË: Dokumentat (p.sh. kontratat, fletëllogaritë, faturat, çertifikat e lindjes, shkrimet, mail-et, dëshmimtarët – adresën e të cilëve duhet ta përmendni, ekspertimi – që do ta caktojë gjykata, hetimi – që përdoret rallë në kontest)

JU PROPOZONI DHE DORËZONI prova. Propozimi do të thotë se i përmendni qartë në padi (p.sh. nëse thoni se dikush Ju ka borxh dhe keni dëshmimtarë, propozoni prova: me dëgjimin e dëshmimtarit Pera Periq. Nëse keni fletëllogari, propozoni provë: fletëllogaria nga data 05.05.2010 por kopjon e fletëllogarisë e dorëzoni në disa kopjo, dhe e dorëzoni bashkë me padinë.

Provat Tuaja duhet t'i përmendni në tekstin e padisë dhe t'i dorëzoni në kopjo të mjaftueshme për gjykatën dhe palën e kundërt, përkatësisht t'i dorëzoni në gjykatë më vonë atëherë kur për herë të parë dilni sipas thirrjes së gjykatës (SEANCA PËRGATITORE). **VËREJTJE: PAS KËSAJ NUK KENI TË DREJTË TË PROPOZONI PROVA.**

GJYKIMET ZGJASIN. DERI NË ZBATIM MUND TË KALOJNË DISA VITE. ARMATOSUNI ME DURIM.

2. SHKRUAJTJA E PADISË

2.1 Ligjet dhe të dhënat e nevojshme për shkruajtjen e padisë

Nuk është e lehtë të shkruani padinë. ARMATOSUNI. Pa Ligjin për procesin kontestimor që rregullon tërë procesin dhe Ligjin që regullon fushën për të cilën "paditni", vështirë do të mund të hartoni padinë.

Për shembull, për kontenstin nga kontrata e punës Ju nevojitet Ligji për punën, për dëmshpërblimin Ju nevojitet Ligji mbi obligacionet, për divorcim Ju nevojitet Ligji familjar.

Duhet të dini të dhënat e të paditurit. Sipas adresës së vendbanimit ose selisë të palës së paditur, sipas regullit, do të dini se në cilën gjykatë dorëzoni padinë.

Duhet të caktoni vlerën e kontestit. BËHUNI REAL. Nga vlera e kontestit në fund varet se sa do të jetë taksa që do paguani.

Juristët përdorin **MODELET E PADISË DHE FORMULARËT.**
Prandaj Ju japim shembull.

PADIA PËR DËMSHPËRBLIM
NË RAST TË LËNDIMIT TRUPOR

GJYKATA THEMELORE NË _____

PADITËSI: _____ nga _____, rr.: _____ nr. _____

I PADITURI: _____ nga _____, rr.: _____ nr. _____.

PADIA
Për dëmshpërblim

Vlera e kontestit: RSD _____

I padituri më datën _____, i shkaktoi paditësit lëndime të rënda trupore pasi i thyejti hundën. Për shkak të kësaj vepre i padituri është dënuar prej gjykatës_____ me dënimin me burg me zgjatje prej _____.

PROVË: 1. Shkresat e gjykatës _____ K. Nr. _____
2. Vërtetimi i mjekut për paditësin.

Për shkak të këtij lëndimi paditësi përkohësisht nuk punoi gjatë _____ muajve, dhe humbi fitimin prej RSD _____.

PROVË: Vërtetimi nga punëdhënësi i paditësit _____, prej _____ të vitit.

Paditësi pas lëndimit ka patur dy operacione në hundë, gjë që rezultoi me dhimbje të forta fizike për një kohë të gjatë. Paditësi mendon se dëmshpërblimi i duhur për kompensimin e këtyre dhimbjeve është shuma prej _____ RSD.

PROVË: Ekspertimi i ekspertëve të profesionit mjekësor

Si pasojë e përhershme e lëndimeve te paditësi ka mbetur frymëmarrja e vështirë dhe për shkak të kësaj te paditësi është ulur aftësia e përgjithshme e jetesës. Paditësi mendon se dëmshpërblimi i duhur me të holla për dhimbjet shpirtërore për shkak të pakësimit të aktiviteteve të jetës është shuma prej _____ RSD.

Së fundi, paditësi përjetoi frikë të madhe, në kohën kur u shkaktua lëndimi dhe më vonë gjatë kryerjes së operacioneve duke patur frikë nga pasojat e lëndimit, dhe në bazë të dëmshpërblimit për frikën e përjetuar, kërkon shumën prej _____ RSD.

PROVË: Ekspertimi

Për të gjitha të lartpërmendurat, paditësi në bazë të nenit 195 e 200 të Ligjit mbi obligacionet paraqet këtë padi dhe propozon që gjykata pas shqyrtimit të marrë:

AKTVENDIMIN

Obligohet i padituri që paditësit në emër të dëmshpërblimit për shkak të lëndimeve të rënda trupore t'i paguajë:

- Për humbjen e fitimit gjatë kohës së paaftësisë për punë shumën prej _____ RSD,
- Për dhimbjet fizike shumën prej _____ RSD ,
- Për dhimbjet shpirtërore për shkak të pakësimit të aktiviteteve të jetës shumën prej _____ RSD ,
- Për frikën e përjetuar shumën prej _____ RSD, që të gjitha së bashku janë _____ RSD, me kamatën ligjore duke nisur që nga dorëzimi i padisë deri në pagimin si dhe paditësit t'i paguajë shpenzimet e procesit kontestimor, të gjitha brenda afatit prej 15 ditësh me kërcënim të zbatimit.

Në _____,
Më datën _____ _____, _____

NËNSHKRIMI I PADITËSIT

2.2 Çfarë kërkoj nga gjykata: kërkesë padia

Është shumë e rëndësishme që të caktoni **saktësisht se çfarë doni nga gjykata.** Kjo quhet "formulacioni i kërkesë padisë". Kjo është pyetja kryesore në procesin gjyqësor. Sipas regullit, ai formulohet pasi përshkruani ngjarjen/situatën për të cilën bëtë padinë, dhe keni shpjeguar përse Ju takon e drejta.

Ja dhe shembulli:

Për të lartpërmendurat, propozoj që gjykata të marrë aktvendimin ose vendimin me të cilin

KËRKESË PADIA

Miratohet kërkesë padia dhe obligohet i padituri Pera Periq nga Beogradi, që paditësit Marko Markoviq nga Smedereva, t'i paguajë në llogarinë no. vvv-vvvvv-vvv, të hapur te Bank Y, shumën prej 8,000 RSD në emër të borxhit me kamatën ligjore duke nisur nga 15 Maji i vitit 2015, brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit.

Obligohet i padituri Pera Periq nga Beogradi që paditësit t'i paguajë shpenzimet e procesit brenda 15 ditëve

Ja edhe një shembull:

Për të lartpërmendurat, propozoj që gjykata të marrë aktvendimin ose vendimin me të cilin

KËRKESË PADIA

Miratohet kërkesë padia dhe obligohet i padituri, Agroekonom d.o.o., me seli në Beograd, që paditësit në emër të pagesës së papaguajtur për muajin prill të vitit 2016 t'i paguajë vlerën prej 26.000,00 RSD me kamatën ligjore nga data 31.Maj i vitit 2016, deri në pagim; për muajin Maj të vitit 2016 të paguajë vlerën prej 26.300,00 RSD me kamatën ligjore prej 30 Qershorit të vitit 2016;

Obligohet i padituri, Agroekonom d.o.o., me seli në Beograd që paditësit t'i paguajë shpenzimet e procesit brenda 15 ditëve.

2.3. Atëherë kur nuk e di saktë se çfarë dua nga gjykata – saktësimi i kërkesë padisë

Nëse nuk keni mundësi që të caktoni kërkesë padinë sepse nuk e dini p.sh. se sa Ju ka borxh punëdhënësi, atëherë duhet të kërkoni **ekspertimin e profesionit financiaro-ekonomik.** Gjithashtu ndoshta nuk e dini se sa është dëmshpërblimi jomaterial, pra, nëse keni patur ndonjë lëndim apo frikë, Ju nuk jeni në gjendje të vlerësoni se sa është shpërblimi i drejtë për një lëndim të tillë. **Këtë do ta caktojë eksperti gjatë procesit.** Kur të caktojë eksperti vlerat në mendimin dhe konstatimin e vetë, dhe Ju do jeni dakord me mendimin, **do të keni mundësi që të saktësoni shumën** që kërkoni nga personi i cili është përgjegjës që të paguajë dëmshpërblimin. **Atëherë gjykatës do t'i dorëzoni parashtresën me kërkesë padinë e saktësuar.**

NDIHMË!!!!

Modelet shumë shpesh i keni në internet por mund të kontaktoni edhe ndihmën juridike falas për këshillë. Interesohuni në komunën Tuaj a egzistojnë shërbimet për ndihmën juridike falas. Ata do t'Ju ndihmojnë.

3. PARAQITJA E PADISË

- Shkruajtët padinë;
- Printuat disa kopjo (të paktën 2);
- Nënshkruajtët të gjitha kopjot;
- Fotokopjuat të gjitha provat që i keni përmendur në numrin e kopjove njësoj si padinë (të paktën 2);
- Paketuat të gjitha (në zarf)
- **Dorëzuat** zarfin në postë (me fletë kthyese) ose në sportelin e gjykatës;

JU PARAQITËT PADINË!

Së shpejti do të keni **NUMRIN E ÇËSHTJES DHE GJYKATËSIN.** PRISNI THIRRJEN E GJYKATËS ME NUMRIN E ÇËSHTJES ME SHËNIMIN E GJYKATËSIT DHE SALLËS GJYQËSORE. **GJYKATA JU FTON NË SEANCË.**

Që atëherë, çdo fletëdërgesë që dërgoni në gjykatë duhet të përmbajë numrin e çështjes Tuaj.

I PADITURI

1. JAM I PADITUR – ÇFARË DUHET TË DI MË PARË?

Nëse ju ka paditur ndonjë person, ndërsa Ju nuk pranoni kërkesën që ka bërë personi në proces ndaj Jush, keni të drejtë të paraqitni **përgjigjen ndaj padisë.**

KUJDES!!! Nëse nuk do të dorëzoni përgjigjen ndaj padisë brenda afatit të caktuar që është theksuar në ftesë, gjykata mund të marrë aktvendimin për shkak të mosardhjes në dëmin Tuaj.

Të keni parasysh se për **përgjigjen ndaj padisë paguhet taksa.** Gjykata ndonjëherë do t'Ju dërgojë lajmërimin, ndonjëherë jo.

- **PËR PËRGJIGJEN NDAJ PADISË PAGUHET TAKSA, QË NË FILLIM.**

- Nëse nuk keni mjete për pagimin e taksës, **mund t'i bëni kërkesë gjykatësit që t'Ju lirojë nga pagesa,** sepse sipas gjendjes Tuaj ekonomike nuk keni mundësi të paguani. **Kujdes!!!** Për gjithçka që thoni duhet të keni prova. Do duhet të dorëzoni dokumentacionin (p.sh. vërtetimin për papunësi nga Enti Kombëtar i punësimit, çekun e pensionit, çertifikatat e lindjes për fëmijët, vërtetimet nga komuna për pronën e palëvizhme, etj.) Mund të kërkoni të paguani taksën me këste. Përdorni të drejtat Tuaja brenda afatit.

- **BARRA E PROVËS ËSHTË MBI PADITËSIN!!!**

Prapëseprapë, për gjithçka që thoni Ju, **duhet të keni prova.**

PROVAT JANË: Dokumentat (p.sh. kontratat, fletëllogaritë, faturat, çertifikat e lindjes, shkrimet, mail-et, dëshmimtarët – adresën e të cilëve duhet ta përmendni, ekspertimi – që do ta caktojë gjykata, hetimi – që përdoret rallë në kontest)

JU PROPOZONI dhe DORËZONI prova. Propozimi do të thotë që t'i përmendni qartë në përgjigjen ndaj padisë (p.sh. nëse thoni se dikush Ju ka borxh dhe keni dëshmimtarë, propozoni prova: me dëgjimin e dëshmimtarit Pera Periqit. Nëse keni fletëllogari, propozoni provë: fletëllogaria nga data 05.05.2010 por kopjon e fletëllogarisë e dorëzoni në disa kopjo, dhe e dorëzoni bashkë me përgjigjen ndaj padisë.

18 UDHËZUES

PËR HERË TË PARË NË GJYKATË DHE PËR HERË TË PARË NË GJYKIM

Provat Tuaja duhet t'i përmendni në tekstin e përgjigjes ndaj padisë dhe t'i dorëzoni në kopjo të mjaftueshme për gjykatën dhe palën e kundërt, përkatësisht t'i dorëzoni në gjykatë më vonë atëherë kur për herë të parë dilni sipas thirrjes së gjykatës (SEANCA PËRGATITORE). **VËREJTJE: PAS KËSAJ NUK KENI TË DREJTË TË PROPOZONI PROVA.**

- **GJYKIMET ZGJASIN. DERI NË ZBATIM MUND TË KALOJNË DISA VITE. NËSE SHANCAT TUAJA JANË TË VOGLA, TË KENI PARASYSH SE SHPENZIMET E GJYKATËS DO TË RRITEN ME VITE TË TËRA, ASHTU SI DHE KAMATA.**
- **VLERËSONI.**

2. SHKRUAJTJA E PËRGJIGJES NDAJ PADISË

2.1 Ligjet dhe të dhënat e duhura për shkrimin e padisë

Nuk është e lehtë të shkruhet përgjigja ndaj padisë. ARMATOSUNI. Pa ligjin për procesin kontestimor që rregullon tërë procesin dhe Ligjin që regullon fushën për të cilën "paditeni", vështirë do të mund të hartoni përgjigjen ndaj padisë. Në krye duhet të bazoheni në numrin e çështjes Tuaj, që e keni marrë me thirrjen. P.sh. P 259/2016. P do të thotë ***Parnica*** (çështjen gjyqësore); 259 është numri i çështjes Tuaj. 2016. është viti në të cilin është regjistruar çështja.

Përgjigja ndaj padisë presupozon para së gjithash leximin me kujdes të padisë. Mos hyni shumë në detaje të tjera. Përqëndrohuni në atë që është kërkesë e padisë dhe provat e propozuara. Përmendni përse padia dhe kërkesë padia është **E PABAZË.** Refuzoni para së gjithash faktet, por mund të sulmoni edhe provat, përkatësisht rregullsinë e tyre (validitetin e tyre).

Të keni parasysh: Nuk keni shumë kohë për shpjegimin e të thënave Tuaja në sallën gjyqësore. Prandaj shënojini të gjitha që dini në fletëdërgesën Tuaj.

2.2. Çfarë kërkoj nga gjykata – refuzimi dhe mospranimi i kërkesës së padisë

Sipas regullit, nëse nuk pranoni kërkesën e padisë, i propozoni gjykatës që këtë padi **TA REFUZOJË**, përkatësisht propozoni që gjykata kërkesë padinë **TA REFUZOJË.** Kërkoni nga gjykata që paditësi të paguajë shpenzimet e gjykatës.

20 UDHËZUES

PËR HERË TË PARË NË GJYKATË DHE PËR HERË TË PARË NË GJYKIM

Pra, pasi lexoni padinë, nëse egzistojnë shkaqet që janë përmendur në Ligjin për procesin kontestimor për refuzimin e padisë, përmendini dhe kërkoni nga gjykata refuzimin e saj. Për kujdes, kërkoni që kërkesë padia të refuzohet. Për këtë do të jepni shkaqet dhe dorëzoni provat bashkë me përgjigjen.

Gjithçka që keni t'i kundërshtoni paditësit, do ta shkruani në përgjigje. Kështu, nëse mendoni se kërkesa është vjetërsuar, duhet ta përmendni atë. Nëse mendoni se nuk keni borxh çmimin, sepse malli nuk është dorëzuar, bëni vërejtje se kontrata nuk është plotësuar. Nëse e dini se dëmi u bë por ju nuk e keni kryer veprën e caktuar, përmendeni gjithashtu këtë gjë.

NDIHMË!!!

Modelet shumë shpesh i keni në internet por mund të kontaktoni edhe ndihmën juridike falas për këshillë. Interesohuni në komunën Tuaj a egzistojnë shërbimet për ndihmën juridike falas. Ata do t'Ju ndihmojnë.

3. PARAQITJA E PËRGJIGJES NDAJ PADISË

- Shkruajtët përgjigjen ndaj padisë;
- Printuat disa kopjo (të paktën 2);
- Nënshkruajtët të gjitha kopjot;
- Fotokopjuat të gjitha provat që i keni përmendur në numrin e kopjove njësoj si përgjigjen ndaj padisë (të paktën 2);
- Paketuat të gjitha (në zarf)
- **Dorëzuat** zarfin në postë (me fletë kthyese) ose në sportelin e gjykatës;

JU PARAQITËT PËRGJIGJEN NDAJ PADISË!

Çdo fletëdërgesë tjetër që dërgoni në gjykatë, duhet të përmbajë numrin e çështjes Tuaj.

NË GJYKATË

1. SI TË PËRGATITEM PËR T'IU DREJTUAR GJYKATËS, ÇFARË DUHET TË SJELL NË GJYKATË, SI DUHET TË VISHEM, SI TË GJEJ SALLËN E GJYQIT, ÇFARË NDODH NËSE NUK DO TË PARAQITEM?

Si e përgatit paditësi shprehjen?

Fjalimi Juaj i parë është shprehje e shkurtër e padisë, me rishikim të shkurtër të të thënave të të paditurit të dhëna në përgjigjen ndaj padisë që e keni marrë ndërkohë. Ju duhet të përmendni në shprehje Tuaj a janë të thënat e kundërshtarit Tuaj **TË BAZUARA** apo **TË PABAZUARA,** shpjegoni përse janë të pabazuara dhe propozoni prova që vërtetojnë këtë gjë.

Paditësi: "Qëndroj pas të thënave të dhëna në padi dhe kërkesë padi. Propozoj që gjykata të miratojë kërkesë padinë dhe detyrojë të paditurin që paditësit t'i paguajë borxhin."

"Propozoj që gjykata të shoh kontratat, çertifikatat, kopjot e korespodencës, si dhe këtë kontratë që ia dorëzoj tani gjykatës dhe palës së kundërt; të dëgjohen dëshmimtarët, Pera Periqi, rr. adresa, dhe Simon Caric rr. adresa, dhe për rrethanat... Propozoj që gjykata të caktojë ekspertimin përsa i përket lartësisë së dallimit borxh të fitimit."

Si e përgatit i padituri shprehjen e tij?

Shprehja Juaj e parë është përsëritja e përgjigjes Tuaj ndaj padisë.

I padituri: "Qëndroj pas të thënave të dhëna në përgjigjen ndaj padisë. Propozoj që gjykata kërkesë padinë ta refuzojë për shkak..... Për shkak të kujdesit, propozoj që gjykata ta refuzojë kërkesë padinë për shkak ….."

"Propozoj që gjykata të shoh kontratat, çertifikatat, kopjot e korespodencës, si dhe këtë kontratë që ia dorëzoj tani gjykatës dhe palës së kundërt; të dëgjohen dëshmimtarët, Vanja Lak, rr. adresa, dhe Koja Tatiq rr. adresa, dhe për rrethanat..... Propozoj që gjykata të caktojë ekspertimin përsa i përket lartësisë së dallimit borxh të fitimit."

DUHET TË KENI PARASYSH: Nuk keni shumë kohë për shpjegimin e të thënave Tuaja në sallën e gjyqit. Prandaj përmbajuni parashtresës Tuaj!!!

ÇFARË DUHET TË SJELL NË GJYKATË?

Formoni çështjen Tuaj. Bleni një dosje. Sillni padinë. Sillni provat e tjera (tre kopje të secilit dokument) që vërtetojnë pohimet Tuaja. Të gjitha këto prova do t'i jepni në atë që quhet "seancë përgatitore". Kjo është vajtja Juaj e parë në gjykatë dhe ku gjykatësi vendos se kush duhet të pyetet dhe përse. **Gjithmonë merreni me vete dosjenë Tuaj.**

VISHUNI SIÇ DUHET.

Mbani mend se oficerët e sigurimit të gjykatës do t'Ju kontrollojnë dhe do t'Ju kthejnë pas nëse keni pantallona të shkurtra ose nëse shpatullat i keni të zbuluara, madje edhe në muajt e nxehta të verës. As gishtat e këmbëve nuk duhet të duken. Nëse ju kthejnë, shihni më poshtë **ÇFARË NDODH NËSE NUK DO TË PARAQITEM.**

KU ËSHTË SALLA E GJYQIT?

Mbajeni thirrjen kudo me vete. Në të shkruan numri i sallës së gjyqit dhe emri i gjyqtarit. Pyetni rojet se ku është salla e gjyqit në të cilën do të veni. Gjykatat e mëdha kanë shumë salla të gjyqit.

ULUNI PARA SALLËS SË GJYQIT DHE PRISNI.

Në orarin e caktuar, do të dalë procesmbajtësja dhe do të thërrasë paditësin dhe të paditurin. Hyni menjëherë në sallën e gjyqit ku Ju pret gjykatësi.

ÇFARË NDODH NËSE NUK DO TË PARAQITEM?

Nëse jeni paditës dhe nuk arrini të paraqiteni pa e arsyetuar më parë mungesën tuaj, do të konsiderohet se e keni tërhequr ankesën Tuaj. Ju do të duhet të paguani shpenzimet ligjore.

Nëse jeni i paditur dhe nuk arrini të paraqiteni pa e arsyetuar më parë mungesën tuaj, dhe ka mjaft prova kundër Jush, gjykata ka mundësi, me propozim të paditësit, të marrë aktvendimin. Ju do të paguani shpenzimet ligjore.

MUND TA ARSYETONI MË PARË MUNGESËN ME PROVË.

2. SI BËHET GJYQI

Çdo gjykim përbëhet nga seanca dëgjimore. Kur shfaqeni për herë të parë në gjykatë, keni ardhur në seancën përgatitore. Ajo është specifike sepse është kontakti Juaj i parë me gjykatësin. Pavarësisht nga fakti nëse jeni paditësi ose i padituri, në këtë seancë ju duhet të përsëritni se çfarë kërkoni nga gjykata. Në këtë dëgjim, ju gjithashtu propozoni të nxirren provat. Në këtë seancë gjykata do të pranojë ose refuzojë propozimet Tuaja lidhur me provat. Gjykata mund të mendojë se disa janë të tepërta ose të parëndësishme. Mbani mend se ju duhet të dini se cilët dëshmitarë janë të rëndësishëm për Ju. Këmbëngulni për ata. Nëse keni një numër të madh dëshmitarësh, veproni në mënyrë strategjike: hiqni dorë nga ata që dinë më pak. Paditësi duhet të propozojë një afat brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi. Për shembull, nëse ka dy dëshmitarë, mund të propozoni dy seanca dhe një afat kohor tre mujor për përfundimin e gjykimit. Natyrisht, gjyqtari do të përdorë njohuritë e tija dhe kohën që ka në dispozicion për të përcaktuar këtë afat.

Në seancat e mëvonshme "nxirren provat". Kjo do të thotë se gjykata dëgjon dëshmitarët dhe palët. Pasi përfundon procesi provues, gjykimi mbaron me "PËRFUNDIMIN E SHQYRTIMIT KRYESOR".

3. NË SALLËN E GJYQIT

KU RRI NË SALLËN E GJYQIT?

Nëse jeni paditës, Ju jeni në anën e djathtë të gjykatësit Nëse jeni pala e paditur Ju jeni ana e majtë e gjykatësit.

HYTË NË SALLËN E GJYQIT DHE U ULËT.

FILLON SEANCA: Gjyqi fillon atëherë kur gjykatësi fillon të vërtetojë kush është i pranishëm, duke pyetur se kush është i pranishëm për paditësin. Kur i përgjigjeni gjykatësit, qëndroni në këmbë! Atëherë paditësi thotë se është personalisht, pra, i tregon gjykatësit, je ai/ajo është paditës. Gjykatësi përsërit atë që thoni Ju, sepse i flet procesmbajtëses, e cila gjatë tërë gjyqit shënon në **PROÇESVERBAL.**

Pastaj gjykatësi pyet kush flet në emër të të paditurit. Kur i përgjigjeni gjykatësit, qëndroni në këmbë! Atëherë i padituri thotë se është personalisht. Pasi konstaton se janë paraqitur të thirrurit, gjykatësi ia jep fjalën paditësit.

PADITËSI ÇOHET DHE I DREJTOHET GJYKATËS.

Mbani MEND: Nuk bisedoni dhe kurrë nuk i drejtoheni të paditurit. Jeni të drejtuar drejt gjykatësit, gjykatësi Ju dëgjon, pyet, dhe i dikton procesmbajtësit në gjuhën që përdoret në sallën e gjyqit.



PADITËSI FLET:

"Qëndroj pas të thënave të dhëna në padi dhe kërkesë padinë. Propozoj që gjykata të miratojë kërkesë padinë dhe ta obligojë të paditurin që paditësit t'i paguajë borxhin."

"Propozoj që gjykata të shoh kontratat e dorëzuara, çertifikatat, kopjot e korespodencës, si dhe këtë kontratë që ia dorëzoj tani gjykatës dhe palës së kundërt; të dëgjohen dëshmimtarët Pera Periq, rr. adresa, dhe Simon Cariq rr. adresa dhe pikërisht për rrethanat... Propozoj që gjykata të caktojë ekspertimin përsa i përket lartësisë së dallimit të fitimit."

"Propozoj kornizën kohore prej tre muajsh dhe tre seanca."

I PADITURI FLET:

"Qëndroj pas të thënave të dhëna në përgjigjen ndaj padisë. Propozoj që gjykata kërkesë padinë ta refuzojë për shkak..... Për shkak të kujdesit, propozoj që gjykata ta refuzojë kërkesë padinë për shkak ....."

"Propozoj që gjykata të shoh kontratat, çertifikatat, kopjot e korespodencës, si dhe këtë kontratë që ia dorëzoj tani gjykatës dhe palës së kundërt; të dëgjohen dëshmimtarët, Vanja Lak, rr. adresa, dhe Koja Tatiq. adresa, dhe për rrethanat... Propozoj që gjykata të caktojë ekspertimin përsa i përket lartësisë së dallimit të fitimit."



PO NËSE NUK E KUPTOJ SE ÇFARË MË THOTË GJYKATËSI, PËRKATËSISHT ÇFARË I DIKTON PROCESMBAJTËSIT?

Mos t'Ju vijë turp. Pavarësisht nëse keni mbaruar vetëm shkollën fillore ose fakultetin. Juristët përdorin gjuhë të veçantë. Nëse nuk e kuptoni gjyqtarin, mos ngurroni të thoni që nuk keni kuptuar pyetjen apo ato që kanë hyrë në procesverbal.

ATO QË NDODHEN NË PROCESVERBAL KANË QËNË GJATË GJYQIT. TË GJITHA QË THATË OSE BËTË DHE NUK NDODHEN NË PROCESVERBAL, SIKUR NUK KANË NDODHUR. PRANDAJ, NËSE MENDONI SE DIÇKA ËSHTË KYÇE DHE NUK KA HYRË NË PROCESVERBAL, KËMBËNGULNI QË TË HYJË.

FUNDI I SEANCËS: Gjykatësi shpall fundin e seancës dhe cakton seancën e ardhshme duke diktuar në proçesverbal datën dhe orën. Procesverbali printohet. I afroheni tavolinës së procesmbajtësit për të nënshkruajtur procesverbalin. Dilni nga salla e gjyqit.

4. ÇFARË DO TË NDODH NË SEANCËN E ARDHSHME?

Zakonisht në procesverbal shkruan se çfarë do të ndodh në seancën e ardhshme. Nga fundi i seancës, gjykatësi merr vendim që ka të bëjë me rjedhën e procesit p.sh. thërret dëshmimtarët të vijnë, përkatësisht ekspertët që të japin mendimin dhe konstatimin e tyre.

Seanca e ardhshme fillon gjithmonë njësoj. Gjykatësi vërteton a janë të gjithë të pranishëm. Pastaj thërret paditësin që të flas. Paditësi propozon që kërkesë padia të miratohet. Pastaj propozon që të nxirret prova e caktuar në seancën paraprake. P.sh. propozoj të dëgjohet dëshmimtari Pera Periq.

I padituri propozon që kërkesë padia të refuzohet. Pastaj propozon që të nxirret prova e caktuar në seancën paraprake.

Nëse është thirrur dëshmimtari, do të dëgjohet dëshmimtari. Gjykatësi do të pyes dëshmimtarët. Pastaj do të thërras paditësin dhe të padituri që të bëjnë pyetje. Shihni gjykatësin derisa pyetni. Dëshmimtari i përgjigjet gjithashtu gjykatësit. **Mos e komentoni dëshmimin.**

Ekspertimi është zakonisht me shkrim. Palogjikshmëritë në mendim e konstatim mund të kontestohen. Nëse nuk e pranoni mendimin dhe konstatimin, mund të kërkoni ekspertim plotësues, ose ekspertim të ri. Ekspertit i paguani paradhënie.

5. FUNDI I GJYKIMIT

Kur nuk ka më dëshmimtarë, gjykata do të përfundojë procesin provues. Kini kujdes – nëse jeni paditës deri atëherë është dashur të saktësoni kërkesë padinë. Menjëherë pasi konstatohet në procesverbal se përfundoi procesi provues, do t'Ju pyesin të jepni fjalën përfundimtare. Qoftë të jeni paditës ose i paditur, flisni përsëri për provat që janë në interesin Tuaj, dhe kërkoni nga gjykata që në bazë të provave të miratojë përkatësisht të refuzojë kërkesë padinë.

Prisni aktvendimin (rreth një muaj).

ME FAT.

REZULTATET E MUNDURA TË NJË GJYKIMI

JU JENI PADITËS	JU JENI I PADITUR
SITUATA 1 Morrët aktvendimin. U pranua kërkesa Juaj. Prisni a do të ankohet pala e kundërt. As pas dy muajve nuk Ju arriti ankesa. Veni në gjykatë dhe verifikoni a ka arritur ankesa. Nuk është bërë dhe kaloi afati për ankesë. Urime!	SITUATA 1 Morrët aktvendimin. U refuzua kërkesë padia. Prisni a do të ankohet pala e kundërt. As pas dy muajve nuk Ju arriti ankesa. Veni në gjykatë dhe verifikoni a ka arritur ankesa. Nuk është bërë dhe kaloi afati për ankesë. Urime!
SITUATA 2 Morrët aktvendimin. U pranua kërkesa Juaj. Ju arriti ankesa. Mund të shkruani përgjigjen ndaj ankesës. Prisni vendimin e gjykatës së shkallës së dytë. Refuzuan ankesën si të pabazuar, pra, vërtetuan aktvendimin e shkallës së parë (pas një viti). Urime!	SITUATA 2 Morrët aktvendimin. U refuzua kërkesë padia. Ju arriti ankesa. Mund të shkruani përgjigjen ndaj ankesës. Prisni vendimin e gjykatës së shkallës së dytë. Refuzuan ankesën si të pabazuar, pra, vërtetuan aktvendimin e shkallës së parë (pas një viti). Urime!
SITUATA 3 Morrët aktvendimin. U pranua kërkesa Juaj. Ju arriti ankesa. Mund të shkruani përgjigjen ndaj ankesës. Prisni vendimin e gjykatës së shkallës së dytë. E miratuan ankesën si të bazuar. Do ktheheni në gjykimin e shkallës së parë, pra, përsëri në gjykim. (Urimi i mundshëm, por për pritjen)	SITUATA 3 Morrët aktvendimin. U refuzua kërkesë padia. Ju arriti ankesa e paditësit. Mund të shkruani përgjigjen ndaj ankesës. Prisni vendimin e gjykatës së shkallës së dytë. E miratuan ankesën si të bazuar. Do ktheheni në gjykimin e shkallës së parë, pra, përsëri në gjykim.(Urimi i mundshëm, por për pritjen)

JU JENI PADITËS	JU JENI I PADITUR
SITUATA 4 Morrët aktvendimin. U pranua kërkesa Juaj. Ju arriti ankesa. Mund të shkruani përgjigjen ndaj ankesës. Prisni vendimin e gjykatës së shkallës së dytë. E miratuan ankesën si të bazuar. E anulluan aktvendimin dhe refuzuan kërkesën Tuaj. (Humbët, paguani shpenzimet e procesit)	SITUATA 4 Morrët aktvendimin. U refuzua kërkesë padia. Ju arriti ankesa. Mund të shkruani përgjigjen ndaj ankesës. Prisni vendimin e gjykatës së shkallës së dytë. Miratuan ankesën si të bazuar. Anulluan aktvendimin dhe miratuan kërkesë padinë. (Humbët, paguani shpenzimet e procesit)
SITUATA 5 Morrët aktvendimin. Nuk u pranua kërkesa Juaj. Ankohuni. Prisni vendimin e shkallës së dytë. Nuk e pranuan ankesën. (Humbët, paguani shpenzimet e procesit të shkallës së parë dhe të dytë)	SITUATA 5 Morrët aktvendimin. U pranua kërkesë padia. Ankohuni. Prisni vendimin e shkallës së dytë. Nuk e pranuan ankesën. (Humbët, paguani shpenzimet e procesit të shkallës së parë dhe të dytë)
SITUATA 6 Morrët aktvendimin. Nuk u pranua kërkesa Juaj. Ankohuni. Prisni vendimin e shkallës së dytë. Miratuan ankesën. Do ktheheni në gjykimin e shkallës së parë, pra, përsëri në gjykim. (Urimi i mundshëm, por për pritjen)	SITUATA 6 Morrët aktvendimin. U miratua kërkesë padia. Ankohuni. Prisni vendimin e shkallës së dytë. Miratuan ankesën. Do ktheheni në gjykimin e shkallës së parë, pra, përsëri në gjykim. (Urimi i mundshëm, por për pritjen)
SITUATA 7 Morrët aktvendimin. Nuk u pranua kërkesa Juaj. Ankohuni. Prisni vendimin e shkallës së dytë. Miratuan ankesën si të bazuar. Anulluan aktvendimin dhe miratuan kërkesën Tuaj. Urime!	SITUATA 7 Morrët aktvendimin. Është pranuar kërkesë padia. Ankohuni. Prisni vendimin e shkallës së dytë Miratuan ankesën si të bazuar. Anulluan aktvendimin dhe refuzuan kërkesë padinë. Urime!

KUSH MUND T'JU NDIHMOJË?

Nr.	Organizata	Adresa
1	Qendra Alternative për vajzat	Balkanska 49/4, 37000 Kruševac
2	Astra – aksioni kundër tregtisë me njerëz	11000 Belgrade
3	Shoqata e konsumatorëve të Serbisë – APOS	Zmaj Jovina 26, P. C. Lupus, 21000 Novi Sad
4	Qendra autonome e femrave	Tiršova 5a, 11000 Belgrade
5	Qendra Ballkanike për migracione dhe aktivitete humanitare	Bulevar Despota Stefana 53, 11000 Belgrade,
6	Qëndra europiane ekologjike	Veljka Vlahovića 17, 35230 Ćuprija
7	Së bashku Së bashku	Sredačka 2, 11000 Belgrade
8	Inciativa për inkluzion VelikiMali	Žarka Zrenjanina 10, 26000 Pančevo
9	Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut (JUKOM)	Kneza Miloša 4, 11000 Belgrade
10	Labris – Organizata për të drejtat lezbike të njeriut	11000 Belgrade
11	Rrjeta e këshillave për të drejtat e njeriut në Serbi - CHRIS, zyra në Valevë	Hajduk Veljkova 61, 14000 Valjevo
12	Rrjeta e këshillave për të drejtat e njeriut në Serbi - CHRIS, zyra në Negotin	JNA 1A, TC 1. sprat, lokali 39 i 40, 19300 Negotin
13	Rrjeta e këshillave për të drejtat e njeriut në Serbi - CHRIS, zyra në Novi Pazar	37. Sandžačke divizije 19/a, 36300 Novi Pazar
14	Rrjeta e këshillave për të drejtat e njeriut në Serbi - CHRIS, zyra në Bujanoc	Trg Karađorđa Petrovića 254/5, 17520 Bujanovac
15	Shkolla e Novi Sadit për gazetari	Daničićeva 3, 21000 Novi Sad
16	Qendra humanitare e Novi Sadit	Arse Teodorovića 3, 21000 Novi Sad

Lloji i shërbimit	E-mail adresa	Numri i telefonit
Mbrojtja dhe përparimi i të drejtave të njeriut të femrave	alternativniczd@gmail.com	00381 37 421 295
Ndihma direkte viktimave të tregtisë me njerëz	astra@astra.rs; sos@astra.rs	00381 11 785 0000 00381 11 785 0001
Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve	apos@apos.org.rs	00381 21 447 488 00381 21 6622 895
Ndihma emotive – psikologjike dhe juridike për femrat viktimë	azc@azc.org.rs	00381 11 266 2222, 00381 11 2656 178, 00381 11 2687 190
Ndihma juridike falas, mbrojtja e të drejtave të njeriut të refugjatëve dhe personave të shpërngulur	office@bcm.org.rs	00381 11 322 0987 00381 11 322 3574
Ofrimi i këshillave të përgjithshme	evropski.ekoloski.centar@gmail.com	00381 35 84 76 654
Edukimi, përkrahja psiko-sociale	zajedno@zajedno.org.rs	00381 11 2421 221 00381 63 335 027
Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve me pengesa në zhvillim	office@velikimali.org	00381 13 344 141 00381 62 755 127
Ndihma juridike falas, mbrojtja e të drejtave të njeriut	office@yucom.org.rs	00381 11 33 44 235 00381 11 33 444 25
Përkrahja të drejtave lezbike të njeriut	labris@labris.org.rs	00381 11 32 27 480
Ndihma juridike falas, mbrojtja e të drejtave të njeriut	office.valjevo@chris-network.org	00381 14 233 390 00381 14 222 333
Ndihma juridike falas, mbrojtja e të drejtave të njeriut	office.negotin@chris-network.org	00381 19 541 955 00381 19 541 956
Ndihma juridike falas, mbrojtja e të drejtave të njeriut	office.novipazar@chris-network.org	00381 20 313 270
Ndihma juridike falas, mbrojtja e të drejtave të njeriut	office.bujanovac@chris-network.org	00381 17 651 793
Avokimi	office@novinarska-skola.org.rs	00381 21 424 246 00381 21 424 344 00381 21 423 206
Ndihma juridike falas, përkrahja psiko-sociale, arsimore dhe të tjera në veçanti për grupet vulnerabël	nshc@eunet.rs	00381 21 423 021 00381 21 423 024

Nr.	Organizata	Adresa
17	Këshilli për të drejtat e njeriut Nish	Obrenovićeva bb, TPC Kalča, II sprat, L-B-39, 18000 Niš
18	Klinika juridike e fakultetit Juridik në Nish	Trg Kralja Aleksandra 11, 18000 Niš
19	Klinikat juridike të fakultetit Juridik të Univerzitetit Union në Beograd	Goce Delčeva 36, 11000 Belgrade
20	Praksis Beograd	Alekse Nenadovića 7/3, 11000 Belgrade
21	Praksis Kralevo	Heroja Maričića 70, 36000 Kraljevo
22	Qendra e resurseve Bor	Kralja Petra I 14, 19210 Bor
23	Shoqata "Parlamenti Popullor"	Đorđa Lešnjaka 7, 16000 Leskovac
24	Shoqata e qytetarëve Forumi demokratik Serb	Kraljice Marije 47/2, 11000 Belgrade
25	Fondacioni ADRA Serbi	Radoslava Grujića 4, 11000 Belgrade
26	Administrata Komunale Rekovac	Svetozara Markovića 2, 35260 Rekovac
27	Komuna e qytetit në Çukaricë	Šumadijski trg 2, 11000 Belgrade
28	Administrata e qytetit Uzhice	Dimitrija Tucovića 52, 31000 Užice
29	Administrata e qytetit Bolevac	Kralja Aleksandra 24, 19370 Boljevac
30	Administrata e qytetit Zhagubica	Trg oslobođenja 1, 12320 Žagubica
31	Administrata e qytetit Veliko Gradishte	Žitni trg 1, 12220 Veliko Gradište
32	Administrata e qytetit Vlasotince	Trg oslobođenja 12, 16210 Vlasotince
33	Administrata e qytetit Zhabalj	Nikole Tesle 45, 21230 Žabalj
34	Administrata e komunës Lebane	Cara Dušana 116, 16230 Lebane
35	Administrata e komunës Bajina Bashta	Dušana Višića 28, 31250 Bajina Bašta
36	Administrata e komunës Beçej	Trg oslobođenja 2, 21220 Bečej
37	Administrata e komunës Bojnik	Trg Slobode 2–4, 16205 Bojnik
38	Administrata e komunës Ivanjica	Venijamina Marinkovića 1, 32250 Ivanjica
39	Administrata e komunës Pirot	Srpskih vladara 82, 18300 Pirot

Lloji i shërbimit	E-mail adresa	Numri i telefonit
Ndihma juridike falas, mbrojtja e të drejtave të njeriut	office@chrin.org.rs	00381 18 526 232 00381 18 526 233
Mbrojtja e të drejtave të femrave	klinika@prafak.ni.ac.rs	00381 18 500 278
Ndihma juridike falas (mjekësore, familjare, e punës dhe e drejta e fëmijëve)	info@pravnifakultet.rs	00381 11 20 95 501
Ofrimi i ndihmës refugjatëve, personave të shpërngulur përkohësisht, të kthyerve dhe romëve	bgoffice@praxis.rs	00381 11 344 44 82 00381 11 344 44 84
Ofrimi i ndihmës refugjatëve, personave të shpërngulur përkohësisht, të kthyerve dhe romëve	kvoffice@praxis.rs	00381 36 312 658 00381 36 312 659
Ndihma juridike falas	office@rcbor.rs	00381 30 456 640
Ndihma juridike falas	office@parlament.org.rs	0700 500 500 00381 16 236 890
Ofrimi i ndihmës refugjatëve nga Kroacia dhe Bosna e Hercegovina	sdfbelgrade@gmail.com	00381 11 3820 250 00381 11 3820 251
Ndihma humanitare, inkluzioni i grupeve vulnerabël, lufta kundër dhunës së bazuar në gjini	office@adra.org.rs	00381 11 3820 250 00381 11 3820 251
Ndihma juridike falas	predsedniksorekovac@gmail.com	00381 35 84 11 004
Ndihma juridike falas	znedeljkovic@cukarica.rs	00381 11 3052 111
Ndihma juridike falas	uprava@uzice.rs	00381 31 590 190
Ndihma juridike falas	ouboljevac@open.telekom.rs	00381 30 463 412 00381 30 463 413
Ndihma juridike falas	opstinazagubica@beotel.net	00381 12 443 686
Ndihma juridike falas	sovgradiste@ptt.rs	00381 12 662 120
Ndihma juridike falas	officeler@vlasotince.rs	00381 16 875 122
Ndihma juridike falas	sozabalj@eunet.rs	00381 21 831 035
Ndihma juridike falas	kabinet@lebane.org.rs	00381 16 843 710
Ndihma juridike falas	sobb@open.telekom.rs	00381 31 865 280
Ndihma juridike falas	becej@becej.rs	00381 21 68 11 888
Ndihma juridike falas	office@bojnik.org.rs	00381 16 821 214
Ndihma juridike falas	soivanjica@hotmail.com	00381 32 664 760
Ndihma juridike falas	kabinet@pirot.rs	00381 10 305 532

Nr.	Organizata	Adresa
40	Administrata e komunës Rashka	Predraga Vilimonovića 1, 36350 Raška
41	Administrata e komunës Ub	3. Oktobra 4, 14210 Ub
42	Administrata e komunës së qytetit Mladenovac	Janka Katića 6, 11400 Mladenovac
43	Administrata e komunës Surçin	Vojvođanska 79, 11271 Surčin
44	Administrata e komunës Zvezdara	Bulevar Kralja Aleksandra 77, III sprat, kanc. 308, 11000 Belgrade
45	Zyra për ndihmën juridike dhe psikosociale viktimave të dhunës në familje të komunës së qytetit Zvezdara	Bulevar Kralja Aleksandra 77, I sprat, kanc. 104, 11000 Belgrade
46	Zyra për ndihmë invalidëve të komunës së qytetit Zvezdara	Dimitrija Tucovića 83, 11000 Belgrade
47	Komuna e qytetit Vraçar	Njegoševa 77, 11118 Belgrade

Lloji i shërbimit	E-mail adresa	Numri i telefonit
Ndihma juridike falas	office@raska.org.rs	00381 36 736 281
Shërbimi informativ	office@raska.org.rs	00381 14 411 622 00381 14 411 260
Ndihma juridike falas	info@mladenovac.rs	00381 11 8241 600 00381 11 8230 145
Ndihma juridike falas	opstina@surcin.rs	00381 11 8442 111
Ndihma juridike falas	dusica.kuzmanovic@zvezdara.org.rs	00381 11 3405 791 00381 11 3405 683
Ndihma juridike dhe psikosociale viktimave të dhunës familjare	leila.ruzdic@zvezdara.org.rs	00381 11 3405 989
Ndihma juridike invalidëve	ivana.malikovic@zvezdara.org.rs	00381 11 7822 547
Ndihma juridike falas	sovracar©vracar.rs	00381 11 30 81 442

YUCOM
Komitet pravnika
za ljudska prava





UKaid from the British people
Kingdom of the Netherlands
EMBAJADA DE ESPAÑA EN BELGRADO
Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
SWEDEN
WORLD BANK GROUP